

STATUT AKT-THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "NEWMED SHIPPING" SHPK

Sot me dt. 10.01.2022 :

KRISTO KALIVOPULLI, atesia Aleksander, datelindja 25.06.1994, Banues ne Tirane, Rruga " Reshit Collaku", Pall. Lani SHPK, 11/3, madhor, me zotesi te plate juridike e per te vepruar, mbajtes i ID J40625070V

Mbeshtetur ne Ligjin nr.990 I date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personal e mesiperm, ka vendosur si me poshte".

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqrise

Neni 1

Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuara , per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni2

Shoqeria do te emertohet **"NEWMED SHIPPING"**
Shpk

Neni3

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane Rruga " Ibrahim Rugova", Pall. Green Park. kulla no 2. Kat no 2. Kodi postar 1002. Tirana, Shqiperi.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakeve te shoqerise.

Shoqeria **"NEWMEDSHIPPING"** Shpk gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare re Biz.nesit.

Neni 5

Shoqeria **"NEWMED SHIPPING "** Shpk **do te kete si objekt: blerje, shitje e anijeve, administrimi, mircmbajtja,, menaxhimi i anijeve dhe udhctimit te tyre, riparimi dhe dhenia me qera e mjeteve te transportit detar etj. importi – eksporti i tyre.**

Ai mund te zhvilloje veprimtari gjithashtu ne fushen e tregtimit me pakice dhe shumice, ne rruge tokesore , ne rruge hekurudhore , ne rruge ajrore dhe detare, transportin e personave me cfaredoltoj mjcti te licnsuar dhe ne cfaredo lloj rruge.

Neni 6



Shoqeria ushtron aktivitetin e saj mbi baze qendre dhe dege ne qytete te tjera te vendit, te cilat do te hapen pasi te kete filluar aktiviteti i shoqerise.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfiton ortakut i vetem i saj.

Ortakut i vetem themelues perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tij te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi, ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Banke si dhe me kapitale te derdhura nga vete ortakut.

Kapitali themeltar per kryerjen e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 1.000 LEKE e ndare ne 1 kuota me vlere 1000 leke secila. Te gjitha keto kuota perkasin ortakut te vetem te shoqerise.

Fitimet qe do te rezultojne pas miratimit te bilancit vjetor nga Ortakut i vetem i shoqerise pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon :

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon ortakut themelues.

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut te Vetem

Neni 11

Ortakut i Vetem ka keto drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me aktin themelues dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne aktin themelues dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga organet e shoqerise.
- Te heqte dore nga shoqeria duke e shperndare ose likuiduar ate. Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun e vetem nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te emeruje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Ortakut i Vetem ka keto detyrime kryesore:

- Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga ai vete.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektiveve dhe te funksioneve te shoqerise.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektiveve te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte i Ortakut te vetem

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga administratori i saj i Pergjithshem. Ne shoqerine “**NEWMED SHIPPING**” Shpk administrator i shoqerise do te jete **Z. Kristo Kalivopulli**, I cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj. Ortaku i vetem mund te emeruje edhe persona te tjere administrator dhe perfaqesues te shoqerise. Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise. Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te vetem.

Mbyllja e Shoqerise:

Neni 13

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortakeve, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqeria likujdohet:

Neni 14

Ortaku I vetem emerom likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne ortakut te vetem, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 15

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku i vetem

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE

“NEWMED SHIPPING” SHPK

Kristo KALIVOPULLI

